



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova - Ministry of Internal Affairs

Kabineti i Ministrit - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

Nr. 0395/2025

Datë: 05.07.2025

Ministri në detyrë i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mbështetje të nenit 10 paragrafi 2 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 07, 01 mars 2019), në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5. i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 3, 18 nëntor 2022) Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (Gazeta Zyrtare Nr. 22, 19 tetor 2011), si dhe në cilësinë e Koordinatorit Qeveritar sipas Planit të Reagimit Kombëtar (PRK), nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Si rezultat i temperaturave të larta që po mbretërojnë në vendin tonë, me qëllim të ruajtjes së pronës dhe mjedisit, parandalimit të humbjes së mundshme të jetës së qytetarëve, ndalohen të gjitha format e ndezjes së zjarrit në ambiente të hapura në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë:
 - 1.1. Djegjen e mbeturinave dhe barit të thatë në fusha dhe prona private;
 - 1.2. Ndezjen e zjarrit në zona pyjore, kullosa, parqe, male, dhe hapësira të tjera të natyrës;
 - 1.3. Përdorimin e qymyrit apo lëndëve tjera djegëse në vende të pambikëqyrura;
 - 1.4. Ndezja e zjarrit për rekreacion apo qëllime argëtimi në natyrë (kamping, piknik etj.) dhe
 - 1.5. Ndezja e fishekzjarreve.
2. Për mos-zbatimin e këtij vendimi, do të shqiptohen sanksione e parapara me legjislacionin në fuqi nga autoritetet përkatëse duke përfshirë edhe ndërmarjen e veprimeve të nevojshme në zbatim të nenit 322 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

XHEMAL SYVECLA



Ministër në detyrë i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Vendimi i dërgohet:

- Policisë së Kosovës;
- Agjencisë së Menaxhimit Emergjent;
- Inspektorateve komunale;
- Njësisë të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit;
- Arkivit të MPB-së.